

Në mbështetje të nenit 17. dhe nenit 21. të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111 dhe Ligji Nr.05/L-009, Komisioni i Auditimit i KRU "Hidromorava"-SH.A. Gjilan, me datë 05.09.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M
Për anulim të konkursit publik
(Rishpallje e konkursit publik)

Anulohet Konkursi Publik Nr.931 i rishpallur me datë 07.08.2024, për pozitën Zyrtar i Auditimit të Brendshëm në KRU "Hidromorava"- SH.A. Gjilan.


A r s y e t i m

Komisioni i Auditimit i Kompanisë Rajonale të Ujësjetjesit "Hidromorava" Sh.A. në Gjilan, me rastin e rishpalljes së Konkursit Publik Nr.931 të dt. 07.08.2024 për plotësimin e pozitës punuese Zyrtar i Auditimit të Brendshëm në KRU "Hidromorava"Sh.A. pas administrimit dhe shqyrtimit të aplikacioneve të kandidatëve në pajtim me nenin 17. dhe 21. të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, me ndryshim plotësim nga Ligji Nr. 04/L-111 dhe Ligji nr.05/L-009, konstatoi se prej gjithsej pesë /5/ kandidatëve të cilët kanë aplikuar për këtë pozitë asnjëri prej tyre nuk i kanë plotësuar kriteret sipas konkursit të publikuar konform dispozitave të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Nga të cekurat si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Obligohet Sekretarja e Ndërmarrjes që të njoftoj NJPMNP si dhe kandidatët që kanë aplikuar për pozitën e Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm dhe i njëjti vendim të publikohet në web-faqe të Ndërmarrjes.

Kryesuesja e Komisionit të Auditimit


(znj. Ferdane Tahiri Sylejmani)

